



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë
Mbledhja nr. 86
Prishtinë, më 5.6.2024, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Xhavit Haliti, Adelina Grainca, Ariana Musliu-Shoshi dhe Doarsa Kica-Xhelili.

Munguan: Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

Të pranishëm në takim: z. Jörn Rohde, ambasador i Republikës së Federale të Gjermanisë në Kosovë.

Pjesëmarrës të tjerë: Besarta Pllana, Leudita Mejzini, Kuvendi i Kosovës dhe Leureta Lumi, QKSS.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Takimin e kryesoi Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

Takim i komisionit me ambasadorin e Republikës së Federale të Gjermanisë në Kosovë, z. Jörn Rohde.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, shprehu ngushëllime ndaj Gjermanisë dhe ndaj atyre që janë prekur nga vërshimet e fundit. Ajo gjithashtu shprehu keqardhjen për humbjen tragjike të një polici në Mannheim dhe shtoi se përkushtimi i policëve që rrezikojnë jetën për t'i shërbyer komunitetit të tyre, është i paçmuar.

Në emër të komisionit, falënderoi për mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë dhe bëri të ditur se viti 2023 ka qenë i rëndësishëm, ku Republika e Kosovës ka treguar qëndrueshmëri dhe ka punuar për arritjet e ardhshme, duke synuar anëtarësimin në BE. Shprehu mendimin se qasja e institucioneve evropiane ndaj Kosovës, gjatë vitit të kaluar, nuk ka qenë e drejtë. Masat e përkohshme ndaj Kosovës ende nuk janë larguar dhe përsërit kërkesën për heqjen e këtyre masave. Lidhur me këtë, tha se Kosova kërkon ndihmën dhe lobimin e Gjermanisë, që këto masa të hiqen sa më shpejt, duke kërkuar një qasje më të balancuar dhe proporcionale në dialog. Ajo shtoi se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Bratislavës, veriu është kthyer në normalitet dhe po bëhet një punë e madhe për integrimin e komunitetit serb. Kryeziu-Hyseni tha se iu dëshiron suksese kandidatëve gjermanë në zgjedhjet evropiane dhe këto zgjedhje janë të vetmet në botë që paraqesin kufij të qartë dhe situata gjeopolitike tregon se sa të rëndësishme janë këto zgjedhje.

Jörn Rohde, falënderoi komisionin për ftesën që i është bërë, duke shtuar se kjo hera e tretë që takohet me komisionin dhe theksoi se një bashkëpunim i tillë është i rëndësishëm. Ambasadori tha se Gjermania do të mbetet një partner i Kosovës në rrugëtimin e saj drejt Evropës, NATO-s, duke theksuar se janë të përgatitur që të bëjnë edhe më shumë. Në lidhje me masat e BE-së ndaj Kosovës, tha se Gjermania është për heqjen e tyre, por për të ndodhur kjo, duhet koordinim në mes 27 vendeve anëtare të BE-së. Ai përmendi se vendimi i planifikuar të merret dy javë më parë u shty për shkak të veprimeve unilaterale dhe të pakoordinuara të Qeverisë së Kosovës, të cilat kanë ndikuar negativisht tek aleatët. Ambasadori kërkoi që të ketë koordinim të ngushtë me miqtë dhe aleatët, duke theksuar se besimi ndërmjet partnerëve është i domosdoshëm për marrëdhënie të shëndosha. Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në KE, bëri të ditur se vitin e kaluar, kur është marrë vendimi në Këshillin e Evropës për të mbështetur aplikimin e Kosovës për anëtarësim në Asambleenë Parlamentare, është marrë 2/3 e shumicës në organet relevante. Ai thekson se ambasadorët gjermanë kanë ndikuar në 47 vende, ku edhe ka pasur sukses. Si pikë të rëndësishme e theksoi nevojën që Kosova të dërgojë draftin e statutit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Gjykatën Kushtetuese, një kërkesë kjo e mbështetur nga BE-ja dhe vendet anëtare të Quint-it. Kjo do të tregojë përkushtimin e Kosovës në procesin e mbrojtjes së pakicave kombëtare. Ai theksoi se në vitin 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka deklaruar se asociacioni duhet të themelohet sipas marrëveshjes së parë të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës dhe dekretuar nga Presidenti i Republikës. Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës mbetet një prioritet dhe veprimet e Kosovës do të përcaktojnë progresin e mëtejshëm.

Doarsa Kica-Xhelili, theksoi se LDK-ja është në pajtueshmëri me perspektivën e ambasadorit dhe pajtohet me çështjet e përmendura nga ai. Tha se është e rëndësishme që diskutimi të fillojë për marrëdhëniet ndëretnike, si një proces i vazhdueshëm dhe jo si veprime të izoluara për të përfshirë masën.

Ajo vuri në dukje se veprimet për shtrirjen e sovranitetit duhet të jenë të menduara mirë, duke mos injoruar marrëdhëniet diplomatike dhe rrugëtimin e Kosovës që nga vitet '90-të. Në atë kohë, bashkëpunimi me aleatët dhe marrja e vëmendjes së tyre kishte qenë kyç për suksesin e Kosovës. Ajo përmendi se kompromiset dhe koncesionet e bëra atëherë, kishin sjellë pavarësinë e Kosovës dhe një vendim sui generis nga Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Duke folur për dialogun, ajo theksoi se ndryshe nga partitë në qeveri, LDK-ja e sheh atë si të devijuar, jo vetëm për shkak të perceptimeve të tyre, por edhe për shkak të ftesës për t'u angazhuar me aleatët që kanë diskutime të drejtpërdrejta me komunitetet. Në vijim, tha se aleatët kanë theksuar se komunitetet ndihen më pak të përfshira se kurrë. Si LDK, tha se shohin sovranitetin nga një qasje më pragmatike, duke shtuar se në epokën moderne, asnjë vend nuk është tërësisht sovran, për shkak të sigurisë, një pjesë e sovranitetit duhet t'i dorëzohet forumit ndërkombëtar. Ajo shprehu mendimin se qeverisë i mungon përvoja politike për të kuptuar se duke shtrirë sovranitetin ose duke ia dhënë një pjesë aleatëve, bëhet më shumë për vendin. Theksoi se koordinimi me aleatët nuk është dorëzim i sovranitetit, por një mënyrë për të shmangur pasojat e veprimeve të pakoordinuara. Në lidhje me draftin e asociacionit, shprehu shqetësimin e saj për përmbajtjen e tij dhe shtoi se nuk është e bindur se Gjykata Kushtetuese ka kapacitetet e nevojshme për të kuptuar dhe interpretuar draftin aktual të dërguar nga vendet e Quint-it. Ajo sugjeroi që Kosova duhet të vijë me një draft të saj për asociacionin, që do t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese. Si parti politike, tha se janë skeptikë sa i përket asaj se a duhet të dërgohet drafti në gjykatë, se kanë shumë dokumente që t'i dorëzojnë në gjykatë, me shpresën se do t'i shërbejnë interpretimit të duhur të dokumentit. Shoi se janë skeptikë jo vetëm nga përmbajtja e draftit, por edhe nga mundësia se çfarë mund të sjellë në të ardhmen, sepse disa gjëra do të mbeten në mes të lobimit diplomatik të Kosovës dhe Serbisë. Theksoi se LDK-ja, koordinimin me aleatët dhe dialogun i sheh të shkëputura nga Serbia. Ky raport shihet si një raport i Kosovës me aleatët e saj dhe jo si një krahasim se si performon Kosova e si Serbia, sepse dy vendet kanë rrugëtime të ndryshme.

Xhavit Haliti, shprehu kënaqësinë për takimin dhe vlerësoi angazhimin e ambasadorit në interes të Kosovës dhe të rajonit. Duke pranuar vërejtjet e ambasadorit, theksoi se Kosova duhet të veprojë në mënyrën e sugjeruar nga ai, për të përshpejtuar integrimin e saj në BE dhe institucionet ndërkombëtare. Kjo është në interesin e botës perëndimore, që kërkon afrim të Kosovës dhe Serbisë me BE-në dhe NATO-n. Shprehu dëshirën që Qeveria dhe Kryeministri të veprojnë në këtë drejtim, duke theksuar se si opozitë, nganjëherë bëjnë diskutime populliste, porse Kryeministri e kalon opozitën me popullizëm, duke e vendosur atë në një situatë të vështirë për t'u shprehur, përveç që ta kritikojnë. Bëri të ditur se në Belgjikë, Francë, Poloni dhe Çeki, ka gjermanë që gëzojnë të drejtat e garantuara nga kushtetutat e vendeve përkatëse dhe nga rregullat e BE-së. Lidhur me çështjen e asociacionit dhe komuniteteve në Kosovë, ai thekson se Kushtetuta e Kosovës i ka zgjidhur këto raporte, por marrëveshja për asociacionin mbetet diskutabile dhe ende në proces. Kërkoj që Qeveria të bashkëpunojë me opozitën dhe vendet e Quint-it, për ta proceduar dhe vendosur këtë çështje në mënyrën më të mirë për të gjithë.

Ariana Musliu-Shoshi, e falënderoi ambasadorin për prezencën e tij në komision dhe që dëgjon nga ai qëndrimin e Gjermanisë, lidhur me të ardhmen e Kosovës.

Sa i përket anëtarësimit të Kosovës në KE, theksoi se z. Frank Schwabe ishte njëri ndër zërat kryesor dhe mbështetës i fuqishëm, duke marrë pjesë aktive në takime, dhe në disa raste, duke folur më shumë sesa vetë delegacioni kosovar. Takimet me ekspertë ligjorë dhe me Dora Bakoyannis, raportuesen për Kosovën, theksoi se rezultuan në tri kushte: asociacioni, shpronësimi dhe zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Manastirin e Deçanit. Nga këto kushte, tha se vetëm vendimi për Deçanin është i përbushur. Kjo ka shkaktuar zhgënjim në mesin e vendeve anëtare të KE-së, të cilat kishin pritur që Kosova të përmbushte të gjitha kushtet për të avancuar në proceset e integritimit evropian. Ajo theksoi se në të gjitha fjalimet e mbajtura ditën kur Kosova u votua në Asamblenë Parlamentare të KE-së, asociacioni ishte tema kryesore. Bëri të ditur se në mbledhjen e fundit të Komisionit të Përhershëm të KE-së, është shprehur zhgënjimi për humbjen e një mundësie të shkëlqyer për të ecur përpara. Vendet anëtare janë të shqetësuara për ndikimin e zgjedhjeve të ardhshme, ndryshimin e ministrave dhe përbërjen e re të Parlamentit dhe Byrosë, gjë që mund të largojë vëmendjen nga çështja e Kosovës. Sa i përket statutit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, ajo theksoi se nuk ka rëndësi se çfarë mendojnë partitë opozitare, pasi Kryeministri Kurti ka pranuar asociacionin, marrëveshjen e Ohrit dhe planin e zbatimit. Nëse Kryeministri e ka pranuar këtë marrëveshje, ai duhet të vazhdojë me dërgimin e statutit në Gjykatën Kushtetuese, për të siguruar anëtarësimin e plotë të Kosovës në KE. Ajo shprehu shqetësimet e saj për shkak të mungesës së veprimeve konkrete nga Qeveria e Kosovës, pasi që vendet mbështetëse mund të humbin vullnetin për të ndihmuar. Gjermania, Franca dhe vende të tjera, kanë sfida të tjera dhe nuk mund të fokusohen vetëm te Kosova. Veprimet e papritura dhe mungesa e koordinimit me aleatët, kanë shkaktuar probleme dhe kanë dobësuar besimin për Kosovën, theksoi znj. Musliu-Shoshi. Sa i përket sanksioneve të BE-së ndaj Kosovës, tha se zbatimi i tyre nuk kërkonte miratimin e 27 vendeve anëtare, por heqja e tyre kërkon pëlqimin e të gjitha vendeve, çka përbën një sfidë të madhe, duke marrë parasysh se disa vende ende nuk e kanë njohur Kosovën. Kjo situatë krijon vështirësi të mëdha, veçanërisht në aspektin financiar për qasjen në fondet e BE-së.

Jörn Rohde, bëri të ditur se ishte zyrtar i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë në Strasburg, duke e këshilluar delegacionin gjerman gjatë kohës kur në rend dite ishte anëtarësimi i Kroacisë në BE. Vendimi për anëtarësimin e Kroacisë, tha se ishte shtyrë për një vit, pasi që kanë pasur disa çështje të pakicave dhe është kushtëzuar që ato duhet të zbatohet. Lidhur me këtë, theksoi se gjëja kryesore është besimi dhe ndërtimi i besimit. Ambasadori tha se është e pabesueshme që z. Radojiçiq, ende nuk është dënuar, por siguroi që kolegët e tij në Beograd janë duke ushtruar presion tek institucionet e Serbisë, lidhur me këtë çështje. Po ashtu, edhe BE-ja ka reaguuar, duke ia vendosur Serbisë kapitullin 35 dhe nuk është hapur asnjë kapitull tjetër. Sa i përket anëtarësimit në KE, theksoi se Gjermania e dëshiron anëtarësimin e Kosovës, sa më parë, por pesë qeveri të ndryshme nuk kanë bërë asgjë për zbatimin e vendimit për

Deçanin, deri në momentin e fundit. Kjo lëvizje e vonshme ka ndikuar negativisht në besimin e ndërtuar. Shtoi se aleatëve i duhen hapa konkretë, duhet të respektohen përkushtimet dhe obligimet që i ka marrë Kosova. Kur është fjala për migracionin, bëri të ditur se autoritetet gjermane kanë liberalizuar Ligjin për migrimin dhe kanë dyfishuar kuotat për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo është një mundësi për të rinjtë e Kosovës, por theksoi se stabiliteti dhe qëndrueshmëria janë çelës për të ndaluar lëvizjet e paparashikueshme dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për vendin. Z. Schwabe dhe Kancelari kanë mbështetur fuqimisht Kosovën dhe vota në Asamblenë Parlamentare ishte e zëshme. Megjithatë, vendimi përfundimtar është në duart e qeverive, dhe nëse nuk ka shumicë të votave, duhet të pranohet kjo gjendje. Kosova duhet të sigurojë hapa konkretë dhe të dërgojë një draft të statutit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Gjykatën Kushtetuese, sepse nuk cenohet sovraniteti i Kosovës me këtë veprim. Theksoi se është e rëndësishme që Kosova të mos nënvlerësojë veten dhe të shfrytëzojë ekspertizën e saj ligjore për të verifikuar dhe avancuar proceset. Ndihma dhe mbështetja janë të disponueshme, por është e domosdoshme që të ecet përpara, me hapa konkretë, për të siguruar një të ardhme të ndritur për Kosovën.

Doarsa Kica-Xhelili, tha se nëse Kosova do të kishte lëvizur përpara me draftin e saj, nuk do të kishte pasur një draft të imponuar, nëse do t'i kishte përmbushur kërkesat kryesore për asociacionin, duke u bazuar në vendimin e vitit 2015.

Jörn Rohde, tha se në Kosovë ka shumë gjurmë gjermane, e njëra ndër to është edhe Fondacioni Friedrich-Ebert, i cili e ka siguruar një draft. Ky draft është i përgatitur me kujdes, duke respektuar linjat e kuqe të Kosovës dhe përbën 80% të asaj që ka propozuar Lajçak. Pavarësisht kësaj, nuk ka ndodhur asgjë, për shkak të mungesës së angazhimit politik apo vullnetit politik. Vitin e kaluar, është ofruar një propozim tjetër, por pa angazhim nga aktorët kryesorë politikë të Kosovës, proceset nuk ecin përpara. Kjo nuk vlen vetëm për qeverinë aktuale, por edhe për ato të mëparshmet. Kosova duhet të ofrojë diçka konkrete dhe të përmbushë kriteret e kërkuara. Theksoi se propozimi i Serbisë, që e parashikon asociacionin, si një entitet të ngjashëm me Republikën serbe, ishte një ide e papranueshme dhe e tmerrshme dhe askush nuk është duke folur për këtë. Kosovës i duhet një propozim që përmbush kriteret dhe që tregon përkushtimin e saj. Propozimi i Fondacionit Friedrich-Ebert mund të jetë një pikënisje e mirë. Kosovës i nevojiten veprime të qarta, që nuk cenojnë sovranitetin e saj, por përkundrazi, tregojnë përkushtimin dhe seriozitetin e saj.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, theksoi se është e rëndësishme, që të largohen masat ndaj Kosovës, sepse nuk ka më arsye që ato të jenë ende në fuqi. Falënderoi ambasadorin për gatishmërinë e tij për të ardhur dhe për t'u takuar me komisionin, si dhe kërkoi që ky bashkëpunim vazhdojë edhe në të ardhmen. Po ashtu e falënderoi atë për kontributin e tij, si ambasador, si dhe për atë që ka bërë Gjermania për Kosovën.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu-Hyseni,

Kryetare e Komisionit